



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 165

Tiranë – E enjte, 5 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 766, datë 3.12.2019	Për pezullimin nga detyra të një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	12973
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 773, datë 4.12.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin “Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të orientuara drejt konsumatorit dhe performancës (rritje fondesh)”.....	12973
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 498, datë 4.12.2019	Për një ndryshim në urdhrin nr. 369, datë 19.9.2019, “Për hapjen e thirrjes së dytë për aplikime për programin IPARD II”.....	12975
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 231, datë 12.11.2019	Për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal.....	12975
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 175, datë 14.11.2019	Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.....	12981
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 176, datë 14.11.2019	Mbi miratimin e rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror.....	12982
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 177, datë 14.11.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për shitjen e kuotave të shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. të shoqëria “ETS” sh.p.k.....	12996

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 178, datë 14.11.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energi” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”, me kapacitet të instaluar 1600 kw; HEC-i “Backa 2”, me kapacitet të instaluar 4000 kw, HEC-i “Backa A”, me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC-i “Backa b”, me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC-i “Backa c”, me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total të instaluar 7320 kw.....	12997
--	--	-------

**VENDIM****Nr. 766, datë 3.12.2019**

**PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA
TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 47, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Arben Malaj, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pezullohet nga kjo detyrë.

2. Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për shkarkimin e z. Arben Malaj nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 773, datë 4.12.2019**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM
TEKNIK 2018, PËR PROJEKTIN
“SHËRBBIMET E FURNIZIMIT ME UJË
DHE KANALIZIMEVE TË
ORIENTUARA DREJT KONSUMATORIT
DHE PERFORMANCËS
(RRITJE FONDESH)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018 për projektin “Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të orientuara drejt konsumatorit dhe performancës (rritje fondesh)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM
TEKNIK 2018, PËR PROJEKTIN
“SHËRBBIMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE
KANALIZIMEVE TË ORIENTUARA DREJT
KONSUMATORIT DHE PERFORMANCËS
(RRITJE FONDESH)”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Teknik si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar Protokollit të Bisedimeve Qeveritare të datës 22 nëntor 2018 dhe shkëmbimit të notave të datës 26.9.2016, hyrë në fuqi në datën 7.6.2017,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Në zbatim të Marrëveshjes gjermano-shqiptare të datës 21 tetor 1988 mbi Bashkëpunimin Teknik, do të mbështetet projekti i mëposhtëm:



“Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të orientuara drejt konsumatorit dhe performancës (rritje fondesh)”,

nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton, se ky projekt vlen për t’u mbështetur.

2. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin e përmendur në paragrafin 1, me shpenzimet e saj shërbime shtesë në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në një vlerë të përgjithshme prej gjithsej 3.000.000,00 euro (me fjalë: tre milion euro). Ajo ngarkon me zbatimin e projektit të përmendur në paragrafin 1, Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit-GIZ GmbH*).

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit të përmendur në paragrafin 1 dhe kujdeset që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin e përmendur në paragrafin 1.

4. Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet nga projekte të tjera, nëse palët e kësaj marrëveshjeje bien dakord për këtë.

5. Angazhimet e marra referuar projektit të përmendur në paragrafin 1 dhe shumës së përmendur në paragrafin 2, në kuadër të Bashkëpunimit Teknik, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në nenin 2. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2022. Nëse kontratat e zbatimit dhe eventualisht të financimit lidhen brenda afatit të parashikuar vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Neni 2

Hollësitat e projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që

do të lidhen ndërmjet institucioneve që janë ngarkuar apo do të ngarkohen me zbatimin e projekteve në kuptimin e nenit 1, paragrafi 2 dhe 3. Kontratat e zbatimit dhe eventualisht financimit u nënshtrohen dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Neni 3

1. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rimbursen, me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane, vlerën e TVSh-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë mbi objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe zbatimit të kontratave të zbatimit dhe eventualisht financimit të përmendura në nenin 2. Taksat mbi konsumin, të mbajtura në këtë kontekst, merren përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

4. Kjo marrëveshje vlen si për projektin e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, ashtu edhe për masat e tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve tona do të duan të mbështesin më tej këtë projekt. Premtimet financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për masat vijuese të projektit të përmendur në nenin 1, paragrafi 1, bëhen të ditura përmes njoftimesh zyrtare nga ana e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e cila i referohet tekstualisht kësaj marrëveshjeje.



Neni 4

Edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e Marrëveshjes gjermano-shqiptare të datës 21 tetor 1988, mbi Bashkëpunimin Teknik të përmendur në nenin 1, paragrafi 1.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Secila palë kontraktuese mund ta shfuqizojë atë me shkrim në rrugë diplomatike në çdo kohë; shfuqizimi bëhet i efektshëm 30 ditë pasi pala tjetër kontraktuese ka marrë njoftimin përkatës.

3. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të kësaj marrëveshjeje.

4. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në mirëkuptim mes palëve përmes bisedash apo negociatash.

Bërë në Tiranë më 11.10.2019, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË

URDHËR

Nr. 498, datë 4.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 369, DATË 19.9.2019, “PËR HAPJEN E
THIRRJES SË DYTË PËR APLIKIME
PËR PROGRAMIN IPARD II”**

Mbështetur në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e

Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, të ndryshuar; në marrëveshjen kuadër, marrëveshjen sektoriale për IPARD II dhe marrëveshjen e financimit,

URDHËROJ:

1. Në pikën 4 (katër) të urdhrit nr. 369, datë 19.9.2019, “Për hapjen e thirrjes së dytë për aplikime për programin IPARD II”, ndryshohet si më poshtë: “Shtyhet afati për aplikime për thirrjen e dytë për aplikime nga programi IPARD II deri në datën 15 janar 2020”. Çdo aplikim që vjen pas datës 15.1.2020 do të refuzohet.

2. Lënien në fuqi të pikave të tjera.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Frida Krifca

**VENDIM
Nr. 231, datë 12.11.2019**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR RREGULLAT E GARANTIMIT TË
MBROJTJES SË DETYRUESHME DHE
CAKTIMIN MBI BAZËN E PARIMIT TË
ROTACIONIT TË AVOKATIT
MBROJTËS, NGA LISTA E AVOKATËVE
QË OFROJNË SHËRBIMET E
NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE NË
PROCESIN PENAL**

Në mbështetje të nenit 49, pika 7 dhe nenit 49/a, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, pika 6 dhe 7, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike, të garantuar nga shteti”; të nenit 159, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës, nga lista e avokatëve që ofrojnë



shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në procesin penal”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

RREGULLORE

PËR RREGULLAT E GARANTIMIT TË MBROJTJES SË DETYRUESHME DHE CAKTIMIN MBI BAZËN E PARIMIT TË ROTACIONIT TË AVOKATIT MBROJTËS NGA LISTA E AVOKATËVE QË OFROJNË SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE NË PROCESIN PENAL

1. Kjo rregullore ka për qëllim miratimin e rregullave të hollësishme që lidhen me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme dhe mbrojtjen për të pandehurin pa mjete të mjaftueshme financiare, në procesin penal, nga ana e institucioneve të parashikuara në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

2. Organi procedues që fillon hetimet detyrohet të zbatojë rregullat për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e Ndhmës Juridike Dytësore në procesin penal.

3. Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik përcjell listat e miratuara, sipas procedurës së poshtëshënuar, si dhe i publikon ato në faqen e saj zyrtare.

4. Përzgjedhja e avokatëve bëhet me rotacion në mënyrë të njëpasnjëshme nga lista, duke filluar nga nr. 1 i listës, më pas kalohet te nr. 2 dhe kështu vazhdohet me radhë deri në mbarimin e listës.

5. Avokatët e përfshirë në listën e ndihmës juridike ushtrojnë funksionet e mbrojtësit ligjor në procesin penal:

a) për të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare, sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

b) për të pandehurit që ndodhen në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 7 dhe nenit 49/a të Kodit të Procedurës Penale.

6. Lista e parë përbëhet nga avokatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

7. Lista e dytë përbëhet nga avokatët e specializuar dhe të trajnuar në çështje për të mitur, për viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe abuzimit seksual.

8. Pranë organit të prokurorisë caktohet një person përgjegjës nga personeli administrativ për respektimin e parimit të rotacionit të avokatëve, sipas listës së miratuar nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë.

9. Kur mbrojtja e detyrueshme nuk mund të sigurohet nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtja garantohej nga lista e avokatëve që ofrojnë Ndhmë Juridike Dytësore në procesin penal.

10. Organi procedues i vendos në dispozicion të ndaluarit/të arrestuarit/të pandehurit për të plotësuar një deklaratë/formular, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ku duhet të deklarojë gjendjen ekonomike dhe të shprehë vullnetin se kërkon të mbrohet me një avokat të caktuar nga shteti.

11. Organi procedues vendos rast pas rasti nëse i ndaluarit/ të arrestuarit/i pandehuri mund të përfitojë mbrojtje nga një avokat i caktuar për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

12. Organi procedues merr masa që të kryejë veprimet në prani të avokatit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

13. Organi procedues në caktimin e avokatëve për ndihmën juridike falas respekton parimin sipas të cilit avokati i caktuar në një fazë të procedimit mbron klientin në të gjitha fazat e hetimit dhe gjyqimit.

14. Avokati mund të zëvendësohet sipas kushteve të kësaj rregulloreje dhe, përjashtimisht, nëse plotësohet të paktën njëri nga këto kushte:

a) avokati është në kushtet e konfliktit të interesit;

b) avokati dhe/ose i ndaluarit/të arrestuarit/i pandehuri paraqet një kërkesë të arsyetuar me shkrim për heqjen dorë;



c) avokati nuk paraqitet para organit procedues në mënyrë të përsëritur dhe të paarsyeshme;

d) avokati, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, nuk është në gjendje për të përfaqësuar klientin në atë çështje;

e) shkaqe të tjera të parashikuara me ligj ose akte nënligjore.

15. Organi procedues nis veprimet hetimore që kanë nevojë për t'u bërë në prani të avokatit mbrojtës, vetëm pas një afati kohor jo më pak se një orë, që nis pas paraqitjes së avokatit tek organi procedues, me qëllim që avokati të konsultohet me të pandehurin dhe aktet e dosjes hetimore.

16. Në rastet kur ndryshojnë kushtet për gëzimin e mbrojtjes së detyrueshme, organi procedues e njofton dhe asiston të pandehurin të aplikojë për përfitimin e ndihmës juridike falas sipas llojit të ndihmës juridike.

17. Organi procedues pas caktimit të avokatit mbrojtës i jep mundësi atij për t'u paraqitur në një kohë sa më të shpejtë në vendin e kërkuar.

18. Organi procedues kontakton me telefon dhe/ose nëpërmjet postës elektronike me avokatin e caktuar në detyrë, sipas renditjes së përcaktuar në listën e vënë në dispozicion nga dhoma vendore e avokatisë.

19. Në rast se avokati i përgjigjet telefonatës ose postës elektronike dhe konfirmon mbrojtjen sipas rastit të paraqitur, atij i lihet një afat i arsyeshëm, kohë jo më e shkurtër se një orë, për t'u paraqitur në vendin e kërkuar.

20. Me marrjen përsipër të mbrojtjes, avokati i caktuar për mbrojtjen juridike dytësore, sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike, të garantuar nga shteti", lidh kontratën për detyrimet e palëve sipas formatit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

21. Në rast se avokati, pas marrjes së njoftimit refuzon marrjen përsipër të detyrës, vijohet me kontaktimin e avokatit të radhës në listë.

22. Në rast se avokati nuk i përgjigjet telefonatës ose postës elektronike, atij i lihet një kohë prej 20 minutash për të kthyer përgjigje.

23. Në rast se avokati është i padisponueshëm, provohet të kontaktohet sërish pas 20 minutash.

24. Në rast të moskthimit të telefonatës/të postës elektronike pas njoftimit të dytë, organi procedues operon menjëherë me kontaktimin e avokatit të radhës në listë.

25. Në rast se avokati në detyrë, sipas kalendarit nuk do t'i përgjigjet thirrjes së organit procedues për 3 raste radhazi, kur kërkohet mbrojtja e tij, ai do të kalojë në fund të listës dhe do të zëvendësohet nga avokati në radhë i listës sipas renditjes. Në këtë rast, avokati zëvendësues nuk e humbet radhën e tij të caktimit në detyrë.

26. Organi procedues njofton me shkrim Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për rastet e refuzimit dhe/ose të mospërgjigjes së avokatëve të caktuar në listën e ofrimit të ndihmës juridike falas.

27. Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë merr masa që, nëse ka mungesë të listave të avokatëve të caktuar në një rreth gjyqësor, t'i kërkojë dhomës vendore të avokatisë më të afërt me organin procedues të atij rrethi gjyqësor, të verë në dispozicion të organeve proceduese listën dhe renditjen e avokatëve të caktuar për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

28. Në momentin e ndalimit, organi procedues ka për detyrë që të njoftojë dhe t'i shpjegojë të ndaluarit/të arrestuarit/të pandehurit:

a) të drejtën e tij/e saj për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, në rast të pamundësisë financiare për ta përballuar vetë një avokat mbrojtës nga tregu;

b) të drejtën e tij/e saj për të përfituar ndihmë juridike falas, në rast se plotësohen kushtet për të përfituar nga mbrojtja e detyrueshme, sipas neneve 49 dhe 49/a të Kodit të Procedurës Penale.

29. Nëse avokati i caktuar për të ofruar ndihmën juridike ka pengesa për angazhimin dhe vazhdimin e mbrojtjes duhet t'i drejtohet organit procedues dhe Dhomës Vendore të Avokatisë me një kërkesë të arsyetuar.

30. Avokati i caktuar nga lista e miratuar për ndihmën juridike pushon se ushtruar funksionet e tij si mbrojtës, kur:

a) ekzistojnë kushtet e mbrojtjes së detyrueshme dhe avokati i ndihmës juridike zëvendësohet sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast, kopja e procesverbalit të zëvendësimit të avokatit e mbajtur pranë organit procedues depozitohet pranë strukturave përgjegjëse që ofrojnë ndihmë juridike;

b) i pandehuri, pa mjete të mjaftueshme financiare, nuk pranon mbrojtjen e mëtejshme të tij, sipas parashikimit në pikën 5, të nenit 24, të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".



31. Prokurori fillon procedurën e zëvendësimit dhe njofton Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

32. Avokati do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë derisa ai të zëvendësohet me një avokat tjetër.

33. Organi procedues i kërkon të ndaluarit/të arrestuarit/të pandehurit që të plotësojë formularin, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për vlerësimin e punës së avokatit të caktuar.

34. Për viktimat e veprës penale dhe viktimat akuzuese për pretendimet e tyre, në lidhje me ngritjen e padisë civile brenda dhe jashtë procesit penal, zbatohen rregullat sipas udhëzimit për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike.

35. I padituri civil në procesin penal, si rregull mbrohet nga i njëjti avokat i caktuar për të ndjekur procesin penal. Në rast se avokati nuk dëshiron të ndjekë çështjen civile, avokati zëvendësohet sipas rregullave të rotacionit dhe sipas kalendarit të çështjeve.

36. Shpërblimi për punën e kryer nga avokati gjatë procesit të dhënies së ndihmës juridike falas bëhet:

a) për ndihmën juridike për personat pa mjete të mjaftueshme financiare kryhen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë;

b) për ndihmën juridike në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 7 dhe nenit 49/a të Kodit të Procedurës Penale, kryhet nga organi i prokurorisë.

37. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregullore organi i prokurorisë dhe i policisë gjyqësore, Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, dhomat vendore të avokatisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

38. Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE JURIDIKE DYTËSORE

Kjo kontratë për ofrimin e shërbimit të Ndhmës Juridike Dytësore (Kontrata) lidhet sot në _____, në datën _____.2020, nga dhe nëpërmjet palëve, si me poshtë:

Prokuroria _____,
përfaqësuar nga z./znj. _____
(këtu me poshtë referuar si “Kontraktori”)
dhe
z./znj. _____, shtetas _____,
lindur më _____,
banues në _____, identifikuar me
ID/pasaportë, me numër personal _____
(këtu më poshtë referuar si “Ofertuesi i Shërbimit”).

Palët në këtë Kontratë do të referohen veçmas si “Pala” ose së bashku si “Palët”.

Neni 1

Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj Kontrate është ofrimi i shërbimit të Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, në favor të personave që kanë përfituar, sipas një vendimi të formës së prerë të gjykatës kompetente, të drejtën e përfitimit të kësaj ndihme falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Neni 2

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

2.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët dhe është e vlefshme për një afat 1-vjeçar (njëvjeçar) nga data e nënshkrimit, por në çdo rast deri në miratimin e listës së re dhe lidhjes së kontratave të reja.

2.2 Afati i kësaj Kontrate mund të rinovohet me marrëveshje me shkrim mes Palëve.

2.3 Përfundimi i Kontratës 1-vjeçare nuk e pengon Ofruesin e Shërbimit të përfaqësojë përfaqësuesin deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, përveç kur ekzistojnë rrethana për zëvendësimin e tij.



Neni 3

Parimet e ofrimit të Ndhmës Juridike Dytësore

3.1 Dhënia e Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit bazohet, veçanërisht, mbi parimet e mëposhtme:

- a) akses i barabartë i individëve në ndihmën juridike;
- b) barazia dhe mosdiskriminimi i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- c) profesionalizmi në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- ç) cilësia, efienca dhe efikasiteti në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- d) ruajtja e konfidencialitetit;
- dh) shmangia dhe paralajmërimi i konfliktit të interesit;
- e) mbrojtja e të drejtave të personave vulnerabel.

3.2 Përveç sa më sipër, dhënia e Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit bazohet mbi parimet e Kodit Etik të Avokatit.

3.3 Shkelja e parimeve të përcaktuara në këtë nen përbën shkelje të rëndë të kësaj Kontrate dhe passjell aplikimin e sanksioneve dhe masave disiplinore, sipas parashikimeve të ligjit për avokatinë apo çdo ligji tjetër të aplikueshëm.

Neni 4

Tarifa e shërbimit dhe mënyra e pagesës

4.1 Tarifa e ofrimit të Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, përcaktohet sipas tarifave në fuqi të miratuara, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

4.2 Kontraktori do të paguajë tarifën e shërbimit në llogarinë bankare të Ofertuesit të Shërbimit, me të dhënat si më poshtë:

Përfituesi;
Banka;
SEIFT;
IBAN.

Neni 5

Detyrimet dhe garancitë e palëve

5.1 Në kuptim të ligjit 111/2017, shërbimet e Ndhmës Juridike Dytësore, që Ofertuesi Shërbimit detyrohet të kryejë, përfshijnë por pa u kufizuar:

- përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje procesin, kërkesa, kërkesëpadi ose çdo kërkesë procedurale që rezulton e nevojshme gjatë procesit në prokurori apo në gjykatë;

- përpilimin e akteve të mbrojtjes për persona kundër të cilëve ka nisur një proces penal, gjyqësor apo administrativ;

- mbledhjen dhe përgatitjen e dokumentacionit provues;

- këshillimin mbi procesin penal/gjyqësor civil ose administrativ;

- përfaqësimin dhe mbrojtjen para prokurorit/gjykatës në çështjet penale/administrative dhe civile;

- përgatitjen e kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore apo të arbitrazhit;

- përgatitjen e çdo lloji kërkesë drejtuar prokurorisë apo çdo gjykate në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, si dhe gjykatat ndërkombëtare dhe çdo organizim në të cilin aderohet Republika e Shqipërisë, lidhur me çështjen për të cilën ofron Ndhmë Juridike Dytësore, në favor të Përfituesit;

- përveç sa parashikohet më sipër, Ofruesi i Shërbimit do të kryejë dhe të gjitha veprimet në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në ligjin për avokatinë, në kuptim të Ndhmës Juridike Dytësore në ligjin nr. 111/2017, si dhe në këtë Kontratë.

5.2 Ofruesi i Shërbimit deklaron se:

i. gëzon të gjitha cilësitë profesionale dhe kualifikimet e nevojshme për të marrë përsipër detyrimet sipas kësaj Kontrate;

ii. do të ofrojë shërbimet e Ndhmës Juridike Dytësore me standardet më të larta profesionale, si dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Kontrate;

iii. do të veprojë në kohë dhe pa shkaktuar asnjë vonesë në ofrimin e Ndhmës Juridike Dytësore, menjëherë me marrjen e njoftimit nga organi i prokurorisë, mbi vendimin e prokurorisë ose të gjykatës e cila ka pranuar kërkesën për dhënien e Ndhmës Juridike Dytësore ndaj Përfituesit;

iv. nuk do të heqë dorë nga dhënia e Ndhmës Juridike Dytësore, përveç kur janë rastet e heqjes dorë të përcaktuara nga ligji për avokatinë, përfshirë por pa u kufizuar në rastin e konfliktit të interesit;

v. në çdo rast të detyrimit për të hequr dorë, Ofruesi i Shërbimit do të informojë menjëherë



prokurorin/gjykatën, me qëllim zëvendësimin e tij. Në këtë rast, Ofruesi i Shërbimit do të vazhdojë të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore deri në zëvendësimin e tij, sipas parashikimeve të ligjit për avokatinë, si dhe do të zbatojë të gjitha detyrimet e parashikuara në ligjin për avokatinë;

vi. do të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore, në favor të Përfituesit, vetëm kundrejt tarifës së shërbimit, pa pasur të drejtën e përfitimeve të tjera, përveç tarifës së shërbimit;

vii. do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate, duke mbajtur të padëmtuar Kontraktorin nga çdo veprim kundër tij;

viii. do mbajë kontakte të rregullta dhe të vazhdueshme me Përfituesin, me qëllim informimin e tij të vazhdueshëm mbi çështjen për të cilin ofron Ndihmën Juridike Dytësore;

ix. do të paraqesë një raport në përfundim të punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë/organi i prokurorisë.

5.3 Kontraktori deklaron dhe garanton se:

i. do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimit tarifën e shërbimit pa vonesa, në përputhje me këtë Kontratë;

ii. do të kryejë të gjitha veprimet dhe do të zbatojë çdo detyrim, sipas ligjit nr. 111/2017, për të mundësuar dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore në favor të Përfituesit.

Neni 6

Klauzola antikorrupsion

6.1 Në lidhje me këtë Kontratë, përveç tarifës së shërbimit të parashikuar në nenin 4 më sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të përfitojë, kërkojë apo pranojë nga Përfituesi apo palë të tjera të përfshira në proces apo në konflikt me të, asnjë pagesë, premtim për pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim, drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë.

6.2 Përveç sa më sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të ofrojë apo do të premtojë, vetë apo nëpërmjet personave të tretë, në favor të Palëve apo të subjekteve të përfshira në proces, ku Ofruesi i Shërbimit jep Ndihmën Juridike Dytësore, asnjë pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim.

6.3 Çdo shkelje e parashikuar, sipas paragrafëve 6.1 dhe 6.2 sa më sipër, do të përbëjë vepër penale në kuptim të legjislacionit penal në fuqi dhe Ofruesi i Shërbimit do të jetë subjekt procedimi, sipas legjislacionit procedural penal dhe subjekt i

procedimit etik, sipas legjislacionit për profesionin e avokatit.

Neni 7

Kontraktuesi i pavarur

7.1 Palët e kësaj Kontrate bien dakord që Ofruesi i Shërbimit është kontraktues i pavarur në raport me Kontraktorin dhe për asnjë arsye ose shkak nuk do të konsiderohet si punëmarrës i tij.

Neni 8

Parimi i mirëbesimit dhe i konfidencialitetit

8.1 Palët nuk do të dëmtojnë interesat e njëra-tjetres, reputacionin dhe imazhin. Ato do të veprojnë në mirëbesim ndaj njëra-tjetres dhe do të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga kjo Kontratë, ligji dhe konventat ndërkombëtare.

8.2 Palët do të veprojnë në mirëbesim, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të ligjshëm të secilës Palë.

8.3 Palët janë të detyruar të mbajnë rreptësisht konfidenciale këtë Kontratë, përmbajtjen e saj, të dhënat personale respektive, si dhe çdo të dhënë tjetër pa asnjë kufizim.

8.4 Asnjë prej Palëve nuk do të konsiderohet se është në shkelje të këtij detyrimi, nëse përhapja apo transferimi i interesave e i të dhënave të mësipërme buron nga një detyrim ligjor, përfshirë por pa u kufizuar në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 9

Përfundimi i kontratës

9.1 Kjo Kontratë përfundon rregullisht sipas afatit të përcaktuar në nenin 2 të saj.

9.2 Kontraktori mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se Ofruesi i Shërbimit shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë apo në ligjin nr. 111/2017.

9.3 Ofruesi i Shërbimit mund të zgjidhë këtë Kontratë, duke njoftuar paraprakisht prokurorin/gjykatën. Në këtë rast Ofruesi i Shërbimit do të vazhdojë të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore ndaj Përfituesit deri në zëvendësimin e tij nga prokuroria/gjykata.



Neni 10
Të ndryshme

10.1 Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen dhe mirëkuptimin mes Palëve dhe shfuqizon çdo marrëveshje tjetër të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj.

10.2 Asnjë ndryshim, përfundim, heqje dorë nga çdo pikë e kësaj Kontrate nuk do të ketë efekt nëse nuk është me shkrim dhe e nënshkruar nga Palët.

10.3 Mosushtimi apo vonesa në ushtrimin e një të drejte ose dëmshpërblimi të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në ligj nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose dëmshpërblimi apo heqje dorë nga të drejta ose dëmshpërblime të tjera. Asnjë ushtrim, pjesor apo i plotë i së drejtës ose i dëmshpërblimit të parashikuar në këtë Kontratë, nuk ndalon ushtrimin e mëtejshëm të të drejtave ose dëmshpërblimeve të tjera.

10.4 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe do të interpretohet, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë.

10.5 Palët do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të Kontratës. Nëse kjo nuk është e mundur, juridiksioni kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që burojnë nga ekzekutimi i kësaj Kontrate është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PALËT

**KONTRAKTORI
PROKURORI**

**OFRUESI I SHËRBIMIT
AV.**

VENDIM
Nr. 175, datë 14.11.2019

**MBI KËRKESËN E OSHEE SHA PËR
SHTYRJEN E AFATEVE TË
PËRCAKTUARA NË RREGULLOREN
PËR KRITERET STANDARDE TË
CILËSISË SË SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, dhe nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 104, pika 4, germa “a”; nenit 113, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë e ERE-s nr. 102/3, datë 7.11.2019, për kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, dëgjoi sqarimet e përfaqësuesve të OSHEE sh.a. pjesëmarrës në këtë mbledhje, dhe

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, bordi i ERE-s vendosi: miratimin e rregullores për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me kërkesë të shoqërisë OSHEE sh.a, si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, në lidhje me realizimin e investimeve të domosdoshme, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 21.12.2018, vendosi shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në përfundim të afateve të përcaktuara në vendimin sipërcituar, pas kërkesës së përsëritur të OSHEE-së, ERE-ja, me vendimin nr. 104, datë 26.6.2019, u shpreh për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar, duke vendosur ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 104, datë 26.6.2019, si në vijim:



- Pika 7.3, e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OSHEE sh.a do të propozojë në ERE për miratim, nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30 Shtator 2019.”.

- Në datën 2.10.2019, është paraqitur në ERE kërkesa e OSHEE-së nr. 400/7 prot., për shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike pas vitit 2021.

- OSHEE-ja kërkon që, në pamundësi të plotësimit të treguesve të cilësisë së furnizimit nga ana e OSHEE-së për arsyet e përmendura në studimin e detajuar (bashkëlidhur shkresës), të shtyhet afati i aplikimit të nivelit të lejuar të kriterëve të standardeve të cilësisë së shërbimit, referuar vendimit nr. 182, datë 10.11.2017, të bordit të ERE-s, duke filluar pas vitit 2021.

- Kërkesa e OSHEE-së jep shpjegime në lidhje me rrethanat që e pamundësojnë përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 104, datë 26.6.2019.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë, OSHEE-ja ka përcjellë:

- Tabelën për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” të plotësuar nga ana e OSHEE-së.

- Studimin e detajuar të treguesve të performancës së rrjetit të shpërndarjes.

- OSHEE-ja ka insistuar në pamundësinë e realizimit të plotë të investimeve të parashikuara në vështirësitë financiare që kjo kompani ka ecuar, për shkak edhe të situatës hidrologjike në vend.

- Përfaqësuesit e OSHEE sh.a., në mbledhjen e bordit, dhanë shpjegime të zgjeruara në lidhje me masat e marra, por dhe rezultatet e ardhura si rrjedhojë e këtyre masave, sa i përket rritjes së cilësisë së shërbimit, uljes së numrit të ndërprerjeve, uljen e kohës mesatare të ndërprerjeve për klient në masën 50% krahasuar me pesëvjeçarin e kaluar

- Përfaqësuesit e OSHEE sh.a. u shprehën të gatshëm për të bërë çdo përpjekje të nevojshme me qëllim arritjen e targetave të vendosur në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, dhe legjislacionit në fuqi.

- OSHEE sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE studimin e detajuar mbi përshkallëzimin e

realizimit të parametrave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara dhe të propozojë nivelet e lejuara të cilësisë së shërbimit, siç është përcaktuar në rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 104, datë 26.6.2019, si më poshtë:

a) Pika 7.3, e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OSHEE sh.a do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 1.1.2021.”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 176, datë 14.11.2019

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË LIDHJEVE TË REJA NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 16, pika 18; të nenit 32; të nenit 42, pika 3; të nenit 53 dhe të nenit 54, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 16 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë e ERE-s, me nr. 102/6 prot., datë 7.11.2019, “Mbi miratimin e rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror”,



konstatoi se:

- Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ERE ka përgjegjësi, mes të tjerave, për të vendosur standardet dhe kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe të furnizimit, veçanërisht për kohën që u duhet operatorëve të transmetimit e të shpërndarjes për të bërë lidhjet dhe riparimet, si dhe mbikëqyr zbatueshmërinë e tyre.

- Bordi i ERE-s, me vendimin e nr. 132, datë 29.8.2019, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror”.

- Me shkresën nr. 566 prot., datë 17.9.2019, ERE kërkoi nga palët e interesit: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, “Albpetrol” sh.a., “Albgaz” sh.a., “TAP AG Albania” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “Anio Oil&Gas” sh.p.k., “Phoenix Petroleum” sh.a. dhe “C.G.C.” sh.p.k., opinionet dhe sugjerimet në lidhje me këtë draftregullore, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve dhe objeksioneve nga palët, rezultoi se është shprehur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet shkresës me nr. 8113/1 prot., datë 2.10.2019, e cila sugjeroi që, në këtë proces, duhet pasur në konsideratë edhe kërkesa e nenit 54, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, për sa ka të bëjë me Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes të miratuar nga ERE.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës me nr. 96 prot., datë 25.9.2019, është shprehur parimisht dakord me draftregulloren e lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror.

- Në tejkallim të afateve të parashikuara për marrjen e mendimeve të palëve të interesit mbi këtë akt, shoqëria “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës me nr. 96/1 prot., datë 2.10.2019, ka dërguar opinion shtesë në lidhje me draftregulloren e lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror, ku shprehet dhe propozon që të bëhen disa ndryshime në nenet 3, pika 18; 5, pika 2; 12, pika 4, germa “c” dhe 24, pika 1.

- Shoqëria “TAP AG Albania” sh.p.k., me korrespondencën elektronike të datës 27.10.2019, është shprehur se:

“TAP nuk kërkohet të sigurojë lidhje direkte për përdoruesit fundorë, TAP lidhet vetëm me OST-të kombëtare. Kjo vijon si nga ligji parësor i BE-së, ashtu edhe nga korniza specifike ligjore e TAP-it, e

zhvilluar në përputhje me përjashtimin e dhënë TAP-it në vitin 2016.”

- Sa i përket propozimit të MIE-s që duhet pasur në konsideratë edhe kërkesa e nenit 54, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, për sa ka të bëjë me Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes të miratuar nga ERE, konstatojmë se:

- Neni 54, i ligjit 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar parashikon se: “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve të kapaciteteve të shpërndarjes dhe rregullave teknike, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, të miratuar nga ERE”.

- ERE, me vendimin e saj nr. 7, datë 10.1.2018, ka miratuar licencën tip të aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror.

- Në vijim, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017, është shprehur për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Për sa më sipër, është e qartë që ERE ka zbatuar gjithë sa parashikohet në legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nuk rezulton që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të ketë depozituar një kërkesë për miratim të Kodit të Shpërndarjes.

- Sa u përket propozimeve të “Albgaz” sh.a. ato janë depozituar në tejkallim të afateve ligjore, nuk janë të arsyetuara e si të tilla nuk janë marrë në konsideratë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



RREGULLORE
PËR LIDHJET E REJA NË RRJET PËR
SEKTORIN E GAZIT NATYROR

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Fusha e veprimit dhe zbatueshmëria e
Rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurën e aplikimit, kriteret për miratimin dhe realizimin e një lidhjeje të re ose modifikimit të një lidhjeje ekzistuese dhe përcaktimin e tarifave përkatëse për lidhjen e pajisjeve të përdoruesit të rrjetit të transmetimit ose të shpërndarjes në sektorin e gazit natyror (me tej referuar si “Rregullorja”).

Kategoritë dhe nënkategoritë e lidhjeve, që janë objekt i kësaj Rregulloreje ose nuk përmbajnë asnjë zgjatje të rrjetit, ose janë vetëm zgjatje të vogla të rrjetit që janë të nevojshme për të furnizuar një përdorues të ri të rrjetit, ose për të modifikuar një lidhje ekzistuese me një rrjet transmetimi ose shpërndarjeje të gazit natyror, për të cilin kostot përkatëse i ngarkohen drejtpërdrejt dhe rimbursohen nga aplikanti.

Në rast se një aplikim për një lidhje kualifikohet si pjesë e planit vjetor të investimeve të operatorit të rrjetit ose të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të operatorit të rrjetit (TYNDP¹), procesi i miratimit do të duhet të përmbushë kërkesat e nenit 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 25.8.2010, dhe të metodologjisë për vlerësimin e TYNDP të ERE-s dhe çdo legjislacioni tjetër në fuqi.

Kjo Rregullore është e zbatueshme për operatorët e rrjetit, me qëllim sigurimin e lidhjeve të gazit për përdoruesit e rrjetit në zonat e tyre të shërbimit, duke përcaktuar procesin e lidhjes.

Neni 2
Autoriteti

Kjo Rregullore bazohet në nenin 16, pika 1 dhe pika 18; në nenin 11; në nenin 32, pika 1; në nenin 42; në nenin 43; në nenin 53; në nenin 54 dhe në

neni 89, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime²

1. Me përjashtim të termave të përcaktuar më poshtë, çdo term, fjalë dhe shprehje e përdorur në këtë Rregullore do të ketë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi. Shprehje të tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si vijon:

2. “Aplikant”, një person fizik apo juridik, që është një përdorues ekzistues ose i ardhshëm i rrjetit, i cili paraqet një aplikim zyrtar, në përputhje me këtë Rregullore, për një lidhje në rrjetin e gazit të një Operatori i Rrjetit.

3. “Objekt”, një objekt (banesë, shtëpi, ndërtesë, ambiente, fabrikë ose një grup prej secilës prej tyre që është subjekt i një aplikimi të vetëm), i cili tashmë është ose do të jetë gati të lidhet me rrjetin e gazit, bazuar në miratimin e lidhjes nga operatori përgjegjës i rrjetit.

4. “Lidhja”, instalimet, pajisjet, mjetet dhe materialet e përdorura, në përputhje me miratimin për lidhjen për të siguruar furnizimin fizik të sigurt të gazit natyror, sipas rastit:

i. për lidhjen e re të një objekti me rrjetin në pikën e lidhjes teknikisht dhe ekonomikisht më të afërt, përfshirë edhe pajisjen matëse; ose

ii. për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, duke përfshirë rritjen e kapacitetit të saj.

5. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termi “lidhje” përfshin të gjitha instalimet, pajisjet, mjetet dhe materialet, dhe punimet përkatëse të kryera për shtrirjen e rrjetit të operatorit përgjegjës deri në pikën e matjes së aplikantit. Ajo përfshin, gjithashtu, të gjithë ose pjesë të çdo zgjerimi ose përforcimi tjetër të nevojshëm më thellë në rrjet, siç merret parasysh në pjesën e tarifave të kësaj Rregulloreje, por ai nuk përfshin instalimet e brendshme të gazit nga ana e klientit jashtë pikës së matjes.

6. “Kapaciteti i lidhjes”, kapaciteti maksimal (pik) i fuqisë, i shprehur në mw, për të cilin lidhja e

² Për lehtësinë e përdorimit, termat e përcaktuar në këtë rregullore, në shumicën e kohës janë përdorur në shkrim *Italic*.

¹ TYNDP=Ten Year Network Development Plan.



kërkuar është projektuar dhe do të jetë e aftë të furnizojë.

7. “Pika e lidhjes”, vendndodhja fizike në rrjetin ekzistues të gazit natyror të operatorit të rrjetit që është pika më e afërt teknikisht dhe ekonomikisht më e justifikueshme, nga ku fillon instalimi i lidhjes së aprovuar drejt objekteve të aplikantit.

8. “Instalimet e brendshme të gazit”, të gjitha tubacionet dhe pajisjet e lidhura të gazit natyror që ndodhen në ambientet e një aplikanti, nga krahu i klientit të pikës së matjes dhe që nuk janë pjesë e rrjetit të gazit natyror të operatorit të rrjetit.

9. “Instalues i autorizuar i gazit”, një person ose entitet i autorizuar, sipas kërkesave ligjore përkatëse për të projektuar në mënyrë të sigurt dhe/ose të instalojë, dhe/ose të riparojë, dhe/ose të ndryshojë ose të bëjë shtesa të një instalimi gazi ose të ndonjë pjesë të tij.

10. “Pika e matjes”, vendndodhja fizike në rrjetin e gazit natyror në ambientet e një klienti, ku janë ose do të instalohen valvula mbyllëse kryesore, matësi i gazit dhe pajisjet dhe instalimet shoqëruese. Pika e matjes që përmban matësin dhe që i përket operatorit të rrjetit, është në të njëjtën kohë, pika e referencës në rrjetin e gazit natyror, nga ku detyrimet dhe përgjegjësitë mbi rrjetin e tubacioneve për instalimet e brendshme të gazit, zhvendosen nga operatori i rrjetit te klienti.

11. “Kostoja aktuale”, kosto direkte që ka operatori i rrjetit për një lidhje të veçantë.

12. “Raporti i përdorimit të kapacitetit të rrjetit”, kapaciteti i lidhjes i aprovuar që duhet t’i vihet në dispozicion aplikantit, i shprehur si përqindje e kapacitetit total të tubacionit kryesor të rrjetit të gazit të OS-së në të cilin do të lidhet objekti i aplikantit.

13. “Tubacion kryesor”, një tub me presion të lartë, të mesëm ose të ulët, pjesë e rrjetit të gazit natyror, për orientimin dhe për shpërndarjen e gazit natyror drejt tubacioneve më të vegjël për të arritur te klientët fundorë dhe familjet.

14. “Zgjatje e vogël e rrjetit” një lidhje e ndërtuar në zonën e shërbimit të operatorit të rrjetit, distanca nga rrjeti e të cilit është brenda kufijve të mëposhtëm:

a) për lidhjet standarde: deri në 100 m;

b) për lidhjet në grup: deri në 500 m;

c) për lidhje të personalizuar: deri në 1 kilometër në mënyrë radiale nga pika e lidhjes më e afërt e rrjetit me gaz natyror të operatorit të rrjetit.

15. “Distanca nga rrjeti”, distanca reale midis pikës së matjes të objektit të aplikantit që synon të lidhet dhe pikës së lidhjes në rrjetin e gazit të operatorit të rrjetit, e matur përgjatë rrugës të tubacionit lidhës që do të ndërtohet.

16. “Çmimi i tregut”, një çmim ose normë e arritur në treg, në kushtet më të favorshme, në kohën kur lidhja është në shqyrtim ose ndërtim.

17. “Operatori i rrjetit” një operator i sistemit të transmetimit dhe/ose i shpërndarjes ose një operator i sistemit të kombinuar për një zonë të caktuar të shërbimit, i licencuar nga ERE, në përputhje me nenin 23, pika 2 dhe nenin 23, pika 3, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

18. “Lidhje standarde”, një lidhje (tubacione polietileni ose çeliku) me një rrjet shpërndarës me një presion më të vogël se 6 bar, pajisur me matës gazi dhe rregullator me kapacitet maksimal të përcaktuar prej 10 nm³/h, për të cilin përdoren pajisje, mjete dhe materiale të standardizuara dhe për të cilin kryhen punime standarde gjatë kohës ndërtimit.

19. “Lidhje në grup”, një lidhje e një ndërtese shumëkatëshe, e një objekti zyrash ose një grupim tjetër i klientëve të mundshëm të gazit në rrjet, me një presion pune prej $p < 6$ bar. Një lidhje e tillë ndërtohet nga pika e lidhjes së rrjetit deri në kufirin e pronës ku është instaluar pajisja rregulluese për të gjithë objektin, dhe prej andej në dy ose më shumë pajisje matëse. Tarifat e lidhjes në grup shprehen për pajisje matëse dhe marrin parasysh përdorimin e ponderuar të kapacitetit të lidhjes dhe gjatësinë/të respektive.

20. “Lidhje e personalizuar”, një lidhje në:

a) rrjetin e transmetimit; ose

b) rrjetin e shpërndarjes, kur presioni tejkalon 6 bar ose atje ku pajisjet maksimale të matjes/rregullimit mundësojnë tejkalimin e kapacitetit 100 kw.

21. “Lidhja e rasteve të veçanta”, në kuptimin e kësaj Rregulloreje, rastet e mëposhtme konsiderohen se janë raste të veçanta për përcaktimin e tarifave të lidhjes:

a) modifikimi i një lidhjeje ekzistuese;

b) rilidhja e një objekti në rrjet pas një shkëputjeje të detyruar nga rrjeti; dhe



c) lidhja brenda rrjetit të të njëjtit operator rrjeti e një përdoruesi, i cili ka pasur më herët një lidhje standarde ose pajisjet matëse, si pjesë e një lidhjeje në grup, në një vend tjetër, në rast zhvendosjeje ose prishjeje të objektit të lidhur;

d) kostot e lidhjes në gjysmëthellësi të rrjetit - një tarifë hyrjeje që i ngarkohet aplikantit vetëm një herë, e cila mbulon kostot që lidhen me efektet që shkakton lidhja në thellësi të rrjetit të gazit natyror dhe llogaritet si një funksion i raportit të përdorimit të kapacitetit të rrjetit.

22. “Marrëveshja e lidhjes”, një marrëveshje tip ose e dakordësuar mes palëve, e lidhur midis operatorit të rrjetit dhe aplikantit që ka të bëjë me realizimin e lidhjes, siç përshkruhet më tej në nenin 15.

Neni 4

Detyrimi për dhënien e një lidhje në rrjet

1. Në varësi të dispozitave të pikës 3 të këtij neni, si dhe kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në këtë Rregullore, çdo aplikant ka të drejtë e lidhjes me rrjetin e gazit natyror të operatorit të licencuar për zonën përkatëse të shërbimit.

2. Lidhja për të gjithë përdoruesit e rrjetit të gazit do të sigurohet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese dhe do të bazohet në një marrëveshje lidhjeje tip apo të dakordësuar.

3. Operatori i rrjetit ka të drejtë të refuzojë një kërkesë për një lidhje apo modifikim të lidhjes, nëse aplikanti ose përdoruesi i rrjetit:

a) nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara në këtë Rregullore;

b) nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike dhe standardet, siç parashikohet në nenin 8;

c) nuk lejon që operatori përgjegjës i rrjetit të hyjë në objektet, siç parashikohet në nenin 5;

d) nuk i plotëson kriteret për vlerësimin e një aplikimi, siç parashikohet në nenin 7;

e) është debitor dhe nuk ka shlyer detyrimet e mëparshme ndaj operatorit të rrjetit;

f) nuk është i gatshëm të paguajë tarifat e lidhjes të llogaritura në përputhje me këtë rregullore (pjesa III);

g) nuk ka shlyer pagesën/at për lidhjen përkatëse, siç është rënë dakord në marrëveshjen e lidhjes me operatorin e rrjetit;

h) rrjeti i operatorit përgjegjës ka kapacitet të pamjaftueshëm për të plotësuar kërkesën e

aplikantit dhe nuk është efiçiente nga ana ekonomike që ta zgjerojë atë.

4. Në rast se operatori përgjegjës, bazuar në vlerësimin e tij vendos që lidhja të mos miratohet, ka detyrimin t'i japë aplikantit një shpjegim të hollësishëm me shkrim, duke i paraqitur të gjitha arsyet teknike, operationale dhe ekonomike për të cilat është refuzuar miratimi i lidhjes.

5. Në rastet e një refuzimi, në kushtet e lartpërmendura, shpjegimi do t'i bëhet me dije ERE-s dhe mund të ankimohet në ERE nga aplikanti.

Neni 5

E drejta e aksesit në objektet e aplikantit

1. Kur aplikon për një lidhje, aplikanti ka detyrimin t'i garantojë operatorit përgjegjës të rrjetit, të drejtën për të hyrë në objektet e tij, në kohën e dakordësuar nga të dyja palët, dhe merr masat e nevojshme në mënyrë që ky i fundit, të mund të verifikojë dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat që lidhen me projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e mëtejshëm të lidhjes, përfshirë kontrollin e instalimeve të brendshme të gazit të aplikantit, sipas neneve 9.5 dhe 9.6 të kësaj Rregulloreje.

2. Operatori përgjegjës i rrjetit mund të refuzojë ekzekutimin e një lidhjeje, në rast se klienti nuk garanton aksesin e përfaqësuesit të operatorit përgjegjës të rrjetit në ambientet e aplikantit për qëllimet e përmendura më lart.

Neni 6

Kategoritë e lidhjeve

1. Në varësi të presionit të rrjetit në pikën e lidhjes, kapacitetit të lidhjes, metodës së lidhjes dhe numrit të matësve të instaluar në një objekt të vetëm dhe të lidhur me një pajisje rregullimi, lidhjet do të grupohen në katër kategori:

a) lidhje standarde;

b) lidhje në grup;

c) lidhje e personalizuar;

d) lidhje sipas një rasti specifik.

Në rastet e një numri të konsiderueshëm aplikantësh ose aplikantësh potencialë për një kategori të caktuar lidhjeje, e cila nuk përmendet në paragrafin 1 të këtij neni, i bëhet me dije operatorit të rrjetit dhe ky i fundit do të marrë në konsideratë



përcaktimin e llojeve të lidhjeve dhe/ose të shërbimeve standarde shtesë, në përputhje me parimet e kësaj Rregulloreje. Kategori të reja lidhjeje, të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, do të konsiderohen pjesë e kësaj Rregulloreje, vetëm pas paraqitjes së kërkesës së argumentuar të operatorit të rrjetit dhe miratimit të ERE-s. Vetëm pasi ERE të ketë miratuar ndryshimet e mësipërme, informacionet që kanë të bëjnë me këto lloj lidhjesh do të vihen në dispozicion të palëve të interesuara në faqen e internetit të operatorit të rrjetit, së bashku me informacionin për të gjitha kategoritë e përfshira në këtë rregullore.

Neni 7

Kriteret e vlerësimit të një aplikimi për lidhje

1. Vlerësimi i një kërkesë për lidhje do të bëhet nga operatori përgjegjës i rrjetit rast pas rasti.

2. Operatori përgjegjës i rrjetit do t'i lejojë aplikantin të plotësojë informacionet që mungojnë ose do t'i kërkojë aplikantit sqarime shtesë nëse është e nevojshme brenda afateve të arsyeshme.

3. Koha e përgjithshme për miratimin dhe për modifikimin e një lidhjeje nuk mund të tejkalojë 2 muaj nga paraqitja e parë e aplikimit, përveç nëse është arritur një marrëveshje e shkruar për një zgjatje të këtij afati midis operatorit të rrjetit dhe aplikantit.

4. Bazuar në veçoritë e lidhjes, kufijtë tregues të parashikuar nga përkufizimi i zgjatjes të vogël të rrjetit dhe kriteret në paragrafin 5 më poshtë, operatori përgjegjës i rrjetit do të vlerësojë përputhshmërinë e aplikimit me kërkesat e nenit 12 të kësaj Rregulloreje. Nëse, sipas gjykimit të operatorit të rrjetit, lidhja e kërkuar do të ketë një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e ardhshëm të rrjetit të gazit, operatori i rrjetit do t'i japë aplikantit me shkrim arsyet e hollësishme pse rasti specifik nuk kualifikohet si lidhje dhe ta këshillojë dhe ta mbështesë atë të veprojë, sipas nenit 1.3 të kësaj Rregulloreje.

5. Në vlerësimin e një kërkesë për lidhje, operatori i rrjetit do të sigurojë përputhshmërinë me kërkesat e:

a) ligjit nr. 32/2016, “Për garantimin e sigurisë së instalimeve nën presion”;

b) rregullat teknike të miratuara nga vendimet e Këshillit të Ministrave, që garantojnë funksionimin e sigurt të pajisjeve dhe instalimeve të gazit natyror;

c) Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes;

d) standardet e zbatueshme;

e) çdo kërkesë tjetër ligjore.

6. Dhe, gjithashtu, do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

a) kërkesat e parashikuara në nenin 4.3 të kësaj Rregulloreje;

b) vendndodhjen e objektit për të cilin kërkohet lidhja, duke përfshirë shtrirjen dhe koordinatat e kufijve të tij;

c) largësinë nga rrjeti;

d) kapacitetin e disponueshëm të rrjetit të operatorit përgjegjës në atë zonë;

e) aspektet e sigurisë gjatë punimeve të zbatimit dhe fazën operative të lidhjes së kërkuar, përfshirë kohën e përgjigjes, në rast të situatave emergjente;

f) përputhshmërinë e parametrave teknikë (diametri, kapaciteti, presioni, etj.) të lidhjes së kërkuar me planin afatgjatë të zhvillimit të rrjetit në zonën përkatëse;

g) aplikimet aktuale dhe potenciale të ardhshme për t'u lidhur në të njëjtën pikë lidhjeje;

h) ndikimin e mundshëm në besueshmërinë e furnizimit me gaz natyror, duke siguruar që asnjë lidhje nuk do të shkaktojë ndonjë efekt negativ të përdoruesit ekzistues të rrjetit dhe, se lidhja nuk duhet të cenohet nga ndonjë prej përdoruesve ekzistues të rrjetit;

i) kërkesat e standardit IOS 18001³;

j) analizat kosto-përfitime të operatorit të rrjetit (financiare, ekonomike, sociale) të lidhjes së realizuar, në përputhje me parimet e përcaktuara nga kjo Rregullore.

Neni 8

Kërkesat teknike për projektimin dhe zbatimin e një lidhjeje

1. Çdo lidhje është pjesë e rrjetit të gazit natyror të operatorit të rrjetit dhe është përgjegjës për zbatimin dhe përputhshmërinë me të gjitha kërkesat minimale teknike dhe të sigurisë që janë në fuqi, përfshirë:



- i. rregullat teknike dhe të Sigurisë në sektorin e gazit natyror, të miratuara, bazuar në nenin 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;
- ii. standardet evropiane në sektorin e gazit natyror;
- iii. standardet e kompanisë OS;
- iv. kodet e rrjetit;
- v. çdo rregull dhe normë dhe çdo legjislacion në fuqi.

Neni 9

Përgjegjësitë dhe të drejtat e operatorit të rrjetit

1. Në përputhje me nenin 41 dhe nenin 53, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, operatori i rrjetit ka përgjegjësinë për projektimin e sigurt, prokurimin, ndërtimin, testimin, komisionimin dhe vënien në punë të një lidhjeje të aprovuar.

2. Edhe kur nënkontraktin punimet e lidhjes, operatori i rrjetit mbetet përgjegjës dhe siguron që zgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe materialeve, si dhe zbatimi i punimeve të lidhjes të kryhen në përputhje me legjislacionin aktual dhe standardet e veta të rrjetit.

3. Operatori i rrjetit do të ofrojë bashkëpunimin më të mirë për çdo aplikant të interesuar për një lidhje, në përputhje me dispozitat dhe afatet e kësaj Rregulloreje.

4. Operatori i rrjetit është përgjegjës për të gjithë sistemin e gazit natyror deri në pikën e matjes. Jashtë pikës së matjes, përgjegjësia i mbetet aplikantit.

5. Operatori i rrjetit do të mbetet përgjegjës për kryerjen e kontrolleve teknike të instalimeve të brendshme të gazit, në të cilat operatori i rrjetit shpërndan/transmeton gaz natyror, duke siguruar që ato të funksionojnë në përputhje me rregulloret teknike në fuqi.

6. Operatori i rrjetit bën kontrollin e instalimeve të brendshme të gazit para dhe gjatë vendosjes në operim të lidhjes dhe në çdo kohë tjetër kur konsiderohet e nevojshme, duke njoftuar paraprakisht aplikantin.

7. Pasi vënia në punë të përfundojë me sukses dhe të dokumentohet, e gjithë përgjegjësia për instalimet e brendshme të gazit bie mbi klientin të cilit i është siguruar lidhja, në përputhje me nenin 10.5 të kësaj Rregulloreje.

8. Gjatë zbatimit të punimeve civile, operatori i rrjetit do të sigurojë që të gjitha rregullat e autoriteteve qendrore dhe vendore janë respektuar dhe do të sigurojë që aplikanti nuk do të dëmtohet nga ndonjë pasojë e veprimeve të papërshtatshme të tij.

Neni 10

Përgjegjësitë dhe të drejtat e aplikantit

1. Aplikanti do të lejojë hyrjen e përfaqësuesve të operatorit përgjegjës të rrjetit në objektet e tij, siç parashikohet në nenet 5, 9.5 dhe 9.6 të kësaj Rregulloreje.

2. Aplikanti do të sigurojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë çdo leje të nevojshme për realizimin/modifikimin e lidhjes së kërkuar. Në rast të kundërt, kjo mund të rezultojë në refuzimin e kërkesës.

3. Një aplikant mund të aplikojë për një lidhje apo modifikim të lidhjes ekzistuese drejtpërdrejt ose nëpërmjet një pale të tretë të autorizuar nga ai.

4. Në përputhje me nenin 17.1 të kësaj Rregulloreje, gjatë vlerësimit të projektit të lidhjes dhe së ofertës financiare të bërë nga operatori i rrjetit, aplikanti mund të përfshijë një instalues të autorizuar të gazit me shpenzimet e veta.

5. Aplikanti siguron që ndërtimi ose modifikimi i çdo instalimi të brendshëm të gazit në objektet e tij do të kryhet vetëm nga një instalues i autorizuar i gazit, në përputhje me rregulloret teknike dhe rregullat dhe normat në fuqi dhe se instalimet e brendshme të gazit do të përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse.

6. Për projektimin dhe zbatimin e punimeve të instalimeve të brendshme të gazit në objektin e aplikantit, aplikanti mund ose:

i. të bjerë dakord me operatorin përgjegjës të rrjetit për të zgjeruar marrëveshjen e lidhjes për të përfshirë edhe ndërtimin e instalimeve të brendshme të gazit brenda objektit të aplikantit, bazuar në çmime të tregut; ose

ii. të kryejë vetë ndërtimin e instalimeve të brendshme të gazit, duke përdorur një instalues të autorizuar të gazit. Pavarësisht kësaj zgjedhjeje, operatori përgjegjës i rrjetit ka të drejtë dhe përgjegjësi të kryejë detyrat e parashikuara në nenet 9.5 dhe 9.6.



7. Aplikanti nuk do të ngarkojë operatorin përgjegjës të rrjetit me asnjë përgjegjësi dhe detyrim që mund të vijë nga dëmet e shkaktuara nga çdo ndërhyrje e paautorizuar e bërë në instalimet e brendshme të gazit brenda objektit dhe/ose përdorimi i papërshtatshëm i instalimeve në fjalë.

PJESA II PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË ZBATIMIT

Neni 11

Informimi i publikut dhe dorëzimi i aplikimit

1. Çdo palë e interesuar për një lidhje do të jetë në gjendje të tërheqë udhëzimet dhe informacionet për lidhjen në faqen e internetit të operatorit të rrjetit dhe/ose të kontaktojë drejtpërdrejt me operatorin e rrjetit, dhe/ose me anë të korrespondencës me shkrim, duke kërkuar detajet dhe shpjegimet e nevojshme për lidhjen e synuar.

2. Operatori i rrjetit do të sigurojë që informacioni dhe shpjegimet e kërkuara do të jepen pa pagesë, brenda 7 ditëve nga marrja e shprehjes së interesit të aplikantit.

3. Brenda 12 muajve nga miratimi i kësaj Rregulloreje, operatorit të rrjetit do të publikojë në faqen e tij të internetit, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme, format të mirëstrukturuar dhe lehtësisht të aksesueshëm e të përdorshëm:

a) përfitimet e përdorimit të gazit natyror, së bashku me rregulloret dhe udhëzimet për përdorimin e sigurt të tij;

b) një hartë të përditësuar dhe të saktë të rrjetit të gazit natyror në zonën e shërbimit të operatorit të rrjetit dhe karakteristikat kryesore të tij;

c) kategoritë e lidhjeve të vëna në dispozicion për përdoruesit e rrjetit, së bashku me karakteristikat teknike standarde dhe kërkesat minimale për secilën prej tyre;

d) udhëzimet, shpjegimet dhe formatet e nevojshme për t'u përdorur kur aplikohet për një lidhje;

e) listën e informacionit të kërkuar për secilën kategori lidhjeje, siç parashikohet në nenin 12;

f) lejet e nevojshme të marra ose për t'u marrë nga operatori i rrjetit dhe lejet e nevojshme që duhet të merren nga aplikanti;

g) formati i aplikimit që duhet të plotësohet për secilën kategori të lidhjes;

h) formati i marrëveshjes së lidhjes për kategoritë e ndryshme të lidhjes;

i) koha e pritshme për secilin hap të procedurës së lidhjes;

j) listën e instaluesve të autorizuar të gazit, së bashku me detajet e kontaktit të tyre, që aplikanti mund të përdorë për të përfunduar instalimet e brendshme të gazit ose për vlerësimin e ofertës;

k) kostot e aprovuara për lidhjet standarde dhe kostot indikative për kategoritë e tjera, të llogaritura në përputhje me pjesën III të kësaj Rregulloreje.

4. Formulari i aplikimit për njërën nga kategoritë e lidhjes, siç parashikohet në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, mund të paraqitet nga aplikanti ose:

a) *online*, duke ndjekur udhëzimet e dhëna në faqen e internetit të operatorit të rrjetit. Në raste të tilla, kopjet origjinale të printuara (ose në masën që është e nevojshme - kopje të noterizuara) të aplikimit dhe dokumentacionit mbështetës, gjithashtu, do të dorëzohen ose dërgohen në zyrat e operatorit të rrjetit; ose

b) duke dorëzuar drejtpërdrejt në zyrat e operatorit të rrjetit një kopje origjinale ose të noterizuar të formularit të plotësuar të aplikimit dhe dokumentacionit mbështetës.

5. Aplikimi dhe ndjekja e tij regjistrohet në bazën e të dhënave të lidhjes së operatorit të rrjetit, siç parashikohet në nenin 18 të kësaj Rregulloreje.

Neni 12

Dokumentet e kërkuara për një aplikim

1. Për të gjitha kategoritë e lidhjeve, një kërkesë do të përmbajë informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

a) letra e aplikimit për lidhjen që specifikon njërën nga kategoritë e lidhjes të listuara në nenin 6;

b) kopje e dokumentit të identitetit (ID) ose e pasaportës së pronarit të shtëpisë; ose

c) fotokopje e Numrit Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS), së bashku me ID-në e administratorit, në rastin e një personi që ushtron aktivitet ekonomik;

d) detajet e kontaktit të individit përgjegjës ose të administratorit, në rastin e një kompanie;

e) adresa e objektit për të cilin paraqitet aplikimi për lidhje;

f) marrëdhënia e pronësisë me objektin: certifikatë pronësie e lëshuar nga zyra e regjistrimit



të pasurive të paluajtshme, kontrata e blerjes, akti i dhurimit, kontrata e qirasë etj.;

g) paraqitja e objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), përfshirë koordinatat e kufijve të tij;

h) koncepti ose projekti i parafizibilitetit, ose projekti teknik i lidhjes së kërkuar, nëse ka;

i) identitetin e përfaqësuesit të autorizuar ose të instaluesit të autorizuar të gazit, nëse aplikohet.

2. Një kërkesë për një lidhje standarde, përveç informacionit të përgjithshëm, sipas paragrafit 1 më lart, gjithashtu do të përmbajë:

a) informacion mbi qëllimin e përdorimit të gazit, që mund të jetë për gatim, ngrohje ose nxehje të ujit;

b) një vlerësim i konsumit vjetor i përlogaritur në metra kub ose në kilovat/orë gaz;

c) leje/t, të cilat aplikanti i ka marrë tashmë në lidhje me këtë kategori lidhjeje.

3. Një kërkesë për lidhje në grup, përveç informacionit të përgjithshëm, sipas paragrafit 1 më lart, gjithashtu përmban:

a) vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit prej 50,000 lekësh shqiptare;

b) informacione mbi natyrën e objekteve që do të furnizohen me gaz natyror;

c) numri i pajisjeve matëse që do të instalohen që në fillim dhe zhvillimi i pritshëm i numrit të pajisjeve të reja matëse që do të lidhen në degëzimin e shumëfishtë;

d) numri maksimal i pajisjeve matëse që mundet të lidhen në degëzimin e shumëfishtë;

e) debiti maksimal për gaz (peak) i kërkuar;

f) një vlerësim i profilit ditor dhe vjetor i konsumit të gazit dhe ndryshimi i tij i pritshëm me kalimin e kohës;

g) kontrata e furnizimit ose një marrëveshje tip paraprake me furnizuesin e mundshëm të gazit;

h) niveli i dëshiruar i presionit;

i) leje/t të cilat aplikanti i ka marrë tashmë në lidhje me këtë kategori lidhjeje;

j) leje/t të cilat aplikanti është gati t'i marrë ose të ndihmojnë operatorin e rrjetit në marrjen e tyre.

4. Një kërkesë për lidhje të personalizuar, përveç informacionit të përgjithshëm në paragrafin 1 më lart, duhet gjithashtu të përmbajë:

a) vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit prej 100,000 lekësh;

b) informacione të përgjithshme për veprimtarinë e biznesit të aplikantit dhe përdorimin

e mëparshëm dhe të ardhshëm të gazit dhe/ose ndonjë lloj tjetër të energjisë;

c) informacione për natyrën e objekteve që do të furnizohen me gaz natyror;

d) kontratën tip të furnizimit me gaz dhe identitetin e furnizuesit;

e) sasia maksimale për gaz (peak) e kërkuar;

f) një vlerësim i profilit ditor dhe vjetor të konsumit të gazit;

g) nivelin e dëshiruar të presionit;

h) leje/t të cilat aplikanti tashmë i ka marrë për realizimin e lidhjes së tij;

i) leje/t të cilat aplikanti është gati të marrë ose të ndihmojë për marrjen e tyre për realizimin e lidhjes së tij.

5. Një kërkesë për një lidhje të një rasti të veçantë, përveç informacionit të përgjithshëm në paragrafin 1 më lart, duhet, gjithashtu, të përmbajë:

a) vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit prej 10,000 lekësh;

b) informacione për natyrën e objekteve që do të furnizohen me gaz natyror;

c) debiti maksimal për gaz (peak) i kërkuar;

d) një vlerësim i profilit ditor dhe vjetor të konsumit të gazit;

e) nivelin e dëshiruar të presionit;

f) leje/t të cilat aplikuesi tashmë i ka marrë për realizimin e lidhjes së tij.

Neni 13

Afatet për përfundimin e procesit të aplikimit

1. Pas paraqitjes së një kërkesë për lidhje, siç parashikohet në nenin 11 dhe nenin 12 të kësaj Rregulloreje, operatori i rrjetit do të lëshojë menjëherë një konfirmim për pranimin e kërkesës, duke përmendur kohën e paraqitjes së tij dhe do të sigurojë informacione standarde, në lidhje me skedulën e parashikuar për vlerësimin e tij dhe hapat e tjerë parashikues të procesit, duke përfshirë kohën, lejet për të marrë etj.

2. Jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga paraqitja e aplikimit, operatori i rrjetit do të:

a) në rast të mungesave në dokumentacion, do të informojë aplikantin të paraqesë çdo të dhënë dhe/ose informacion të munguar që është identifikuar gjatë vlerësimit paraprak të kryer nga operatori i rrjetit. Aplikanti duhet të sigurojë informacionin e munguar dhe sqarimet, brenda 15



ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës nga operatori i rrjetit.

b) konfirmojë plotësinë e aplikimit dhe bie dakord me aplikantin për ditën kur eksperti i operatorit të rrjetit mund të vizitojë vendin ku kërkohet lidhja. Me përjashtim të rastit, kur kushtet e motit nuk lejojnë kryerjen e vizitës në terren, ajo duhet të realizohet jo më vonë se 7 ditë kalendarike pas ditës së marrjes së përgjigjes nga OS-ja.

c) informojë aplikantin që çështja nuk kualifikohet si një lidhje dhe e udhëzon atë që të veprojë në bazë të nenit 7.4 dhe nenit 1.3 të kësaj Rregulloreje.

3. I gjithë procesi për plotësimin e një aplikimi për lidhje, përfshirë vizitën në terren dhe takimet me aplikantin, në asnjë rast nuk do të zgjasë më shumë se 30 ditë nga data e parë e dorëzimit të tij.

Neni 14

Projekti teknik dhe procesi i vlerësimit të kostos

1. Pas mbledhjes së të gjitha informacioneve që mungojnë, sqarimeve shtesë, vizitës në terren dhe çdo takimi tjetër me aplikantin, operatori i rrjetit do të ndërmarrë përgatitjen e projektit teknik dhe vlerësimin e kostos për anën e tij, përkundrejt pikës së matjes dhe pastaj do t'ia paraqesë ato aplikantit brenda afateve vijuese nga marrja e aplikimit të plotë për lidhje:

- a) 1 muaj për një lidhje standarde;
- b) 3 muaj për një lidhje në grup;
- c) 4 muaj për një lidhje të personalizuar ose ashtu si është rënë dakord ndërmjet aplikantit dhe operatorit të rrjetit, në rast të një marrëveshjeje lidhjeje të negociuar;
- d) në varësi të situatave specifike për një lidhje të një rasti të veçantë ose ashtu si është rënë dakord ndryshe ndërmjet aplikantit dhe operatorit të rrjetit, në rast të një marrëveshjeje për lidhje të negociuar.

2. Projekti teknik dhe vlerësimi i kostos së lidhjes do të përgatiten duke marrë parasysh, që:

- a) kur është e mundur, do të merret në konsideratë më shumë se një mundësi alternative teknike për lidhjen;
- b) në përputhje me pjesën III të kësaj Rregulloreje, vlerësimi i kostos së projektit të lidhjes do të bëhet në bazë të çmimeve aktuale të tregut për secilin nga opsionet e lidhjes së zgjedhur;

c) zgjedhja e opsionit më efikas midis alternativave të ndryshme do të bazohet në kriteret e dhëna në nenin 7 dhe pjesën III të kësaj Rregulloreje.

3. Në rast se operatori i rrjetit ofron zbritje ose lehtësime për një aplikant, të njëjtat zbritje dhe/ose lehtësime do t'i ofrohen, gjithashtu, çdo aplikanti tjetër për lidhje.

Neni 15

Oferta e lidhjes

1. Pas zgjedhjes së alternativës më të mirë dhe përfundimit të projektit të lidhjes dhe vlerësimit të kostos, siç parashikohet në nenin 14 më lart, operatori i rrjetit do të informojë aplikantin me shkrim, për:

a) miratimin e lidhjes. Në këtë rast OS-ja do t'i japë aplikantit një ofertë për ndërtimin e projektit të lidhjes që do të përbëhet nga:

- i. vendndodhjet e sakta së pikës së lidhjes dhe së pikës së matjes;
- ii. projekti teknik;
- iii. kostot e lidhjes në gjysmëthellësi të rrjetit;
- iv. kostoja totale e projektit e llogaritur në përputhje me pjesën III të kësaj Rregulloreje;
- v. draftin e marrëveshjes së lidhjes;
- vi. garancinë bankare të kërkuar;
- vii. kohën e propozuar për zbatimin e lidhjes;
- viii. skedulën e pagesave që duhet të bëhen nga aplikuesi;

b) refuzimin e kërkesës për lidhje, së bashku me arsyetimin e hollësishëm për një vendim të tillë, përfshirë informacionin për mënyrën e apelimit pranë operatorit të rrjetit dhe më pas në ERE.

2. Pas marrjes së vendimit të OS-së, siç parashikohet në paragrafin më lart, brenda 15 ditëve kalendarike, aplikanti, kur merr një ofertë, mund:

a) të pranojë ofertën duke firmosur dhe duke dërguar marrëveshjen e lidhjes në operatorin e rrjetit dhe duke ekzekutuar kështu e parë dhe duke përmbushur të gjitha aspektet e tjera, siç parashikohet në marrëveshjen e lidhjes; ose

b) të kundërshtojë ofertën dhe i kërkon operatorit të rrjetit që të fillojë një procedurë konsultimi dhe negocimi dhe, në rast të dështimit të negociatave, të paraqesë një ankesë në përputhje me nenin 17 të kësaj Rregulloreje; ose



c) të refuzojë ofertën. Nëse aplikanti nuk ndërmerr asnjë veprim, brenda 15 ditëve nga marrja e informacionit, atëherë do të konsiderohet si një refuzim automatik dhe aplikanti do të duhet të paraqesë përsëri një aplikim të ri, në qoftë se ai është përsëri i interesuar për një lidhje;

d) kur kërkesa është refuzuar, të kërkojë sqarime shtesë nga operatori i rrjetit, në përputhje me nenin 17 të kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Zbatimi dhe vënia në operim e afateve kohore

1. Pas nënshkrimit të marrëveshjes për lidhje, operatori i rrjetit ose drejtpërdrejt ose duke nënkontraktuar një instalues tjetër të autorizuar të gazit, do të zbatojë punimet civile të projektit për lidhjen përkatëse, sipas kërkesave të cilësisë të parashikuara nga legjislacioni dhe afatet e parashikuara nga kjo Rregullore dhe në marrëveshjen e lidhjes.

2. Pas përfundimit të punimeve, operatori i rrjetit do të testojë dhe do të komisionojë të gjithë instalimin e lidhjes së përfunduar së bashku me instalimet e brendshme të gazit të klientit. Vetëm pas testimit dhe komisionimit të suksesshëm, objektet e aplikantit do të vihen në operim.

3. I gjithë cikli që nga paraqitja e aplikimit për lidhje deri në momentin e vënies në operim të kategorive të ndryshme të lidhjes duhet të bëhen brenda afateve vijuese:

a) lidhje standarde: 3 muaj dhe në asnjë rast më shumë se 4 muaj, përveç nëse është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve;

b) lidhja në grup: 5 muaj dhe në asnjë rast më shumë se 6 muaj, përveç nëse është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve;

c) lidhje e personalizuar: 6 muaj ose ashtu si është rënë dakord ndërmjet aplikantit dhe operatorit të rrjetit, në rastin e një marrëveshjeje për lidhje të negociuar;

d) lidhje e një rasti të veçantë: në varësi të rrethanave specifike ose ashtu si është rënë dakord ndërmjet aplikantit dhe operatorit të rrjetit në rast të një marrëveshjeje lidhjeje të negociuar.

Neni 17

Ankesat

1. Në rastet kur, në përputhje me nenin 15.2(a)(ii) dhe 15.2(b) të kësaj Rregulloreje, aplikanti dëshiron të bëjë një vlerësim të pavarur të projektit teknik të lidhjes dhe ofertës financiare, ai ka të drejtën që me shpenzimet e veta të përfshijë një instalues të autorizuar të gazit. Operatori i rrjetit, pas marrjes së një kërkesë nga aplikanti do t'i vërë në dispozicion atij pa pagesë:

a) projektin e hollësishëm teknik dhe vlerësimet përkatëse të kostos së tij;

b) të dhënat teknike përkatëse dhe kushtet e rrjetit nën të cilat do të zbatohet lidhja e kërkuar;

c) kërkesat minimale teknike të operatorit të rrjetit që duhet të përmbushen nga instalimet e reja dhe pajisjet që do të instalohen;

d) pikën e lidhjes, së bashku me çdo mundësi tjetër alternative nëse është e mundur;

e) çdo informacion tjetër të nevojshëm për vlerësimin e duhur të çështjes siç kërkohet në mënyrë specifike dhe të arsyeshme nga aplikanti.

2. Pas përfundimit të vlerësimit, të dy palët do të negociojnë në mirëbesim për të arritur një marrëveshje.

3. Në rast se operatori i rrjetit dhe aplikuesi nuk arrijnë marrëveshje, aplikanti mund ta paraqesë çështjen në ERE.

Neni 18

Baza e të dhënave të lidhjeve dhe raportimi

1. Brenda 12 muajve nga miratimi i kësaj Rregulloreje, operatori i rrjetit do të krijojë një bazë të dhënash elektronike (IT) për monitorimin e lidhjeve, e aftë të regjistrojë dhe të mundësojë aksesin nga ERE në të dhënat aktuale dhe historike për lidhjet për të cilat është paraqitur një aplikim dhe ato të përfunduara, së bashku me veprimet në kohë për to, produktet standarde dhe jostandarde të lidhjeve të ofruara, kapacitetet dhe veçoritë teknike, tarifat e marra dhe shpenzimet e bëra, si dhe strukturën e kostos.

2. Në vijim të krijimit të bazës së të dhënave për monitorimin e lidhjeve dhe në asnjë rast më vonë se dy vjet nga miratimi i kësaj Rregulloreje, operatori i rrjetit është e detyruar të paraqesë në ERE të dhëna dhe informacione të nevojshme për



monitorimin e lidhjeve me rrjetet, përfshirë të dhënat dhe informacion mbi:

a) numrin e aplikimeve të paraqitura, të miratuara dhe të zbatuara për t'u lidhur nga grupet e klientëve;

b) numrin e klientëve të shkëputur.

Neni 19

Marrëveshja e lidhjes

1. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, Operatori i Rrjetit do të hartojë dhe paraqesë për miratim në ERE marrëveshjet e lidhjeve të standardizuara për të gjitha llojet e kategorive të lidhjes.

2. Marrëveshjet e lidhjes të standardizuara dhe të miratuara do të publikohen në faqen e internetit të operatorit të rrjetit.

3. Marrëveshja e lidhjes do të përmbajë ndër të tjera:

a) identitetin e palëve;

b) detajet teknike të lidhjes;

c) skedulën e pagesave;

d) skedulën e punimeve të ndërtimit dhe aktivitetet përkatëse;

e) detyrimet e palëve.

4. Për lidhjet e personalizuara dhe lidhjet e rasteve të veçanta, termat dhe kushtet e marrëveshjes së lidhjes mund të jenë subjekt i negociatave midis operatorit të rrjetit dhe aplikantit.

Neni 20

Aplikime të shumëfishta

1. Në rast se pothuajse në të njëjtën kohë paraqiten më shumë se një aplikim dhe rrugët e linjave përkatëse të lidhjes mbivendosen plotësisht ose pjesërisht, operatori i rrjetit do të konsiderojë dhe/ose do të mundësojë një marrëveshje midis aplikantëve për optimizimin dhe ndarjen e kostove midis tyre, bazuar në parimin e përdorimit të ponderuar të kapacitetit të lidhjes dhe të gjatësive përkatëse të rrjeteve që u shërbejnë klientëve.

2. Kur, në gjykimin e operatorit të rrjetit, përveç një aplikanti të vetëm ekziston mundësia që edhe palë të tjera të përdorin gaz në të ardhmen e afërt, operatori i rrjetit do të organizojë një takim të palëve në fjalë dhe do të bëjë një vlerësim të kërkesës për gaz, brenda së njëjtës zonë të rrjetit, dhe do ta marrë atë në konsideratë në projektimin e

lidhjes. Ky qëllim, sidoqoftë duhet të shmangë mbipagesën për aplikantin/tët e parë.

PJESA III

TARIFAT E LIDHJES

Neni 21

Kriteret për përcaktimin e tarifave të lidhjes

1. Kriteret për përcaktimin e tarifave të lidhjes përfshijnë:

a) kapacitetin e aprovuar të lidhjes;

b) kushtet e terrenit që karakterizojnë vendndodhjen e lidhjes dhe nëse lidhja do të kryhet në mjedise urbane ose rurale;

c) lloji i pajisjeve, mjeteve (përfshirë pajisjet matëse) dhe materialet e përdorura për përfundimin e një lidhjeje të veçantë;

d) lloji i punimeve të nevojshme për t'u kryer për të mundësuar lidhjen.

2. Kur përcakton dhe llogarit tarifat e lidhjes, operatori i rrjetit do të përfshijë vetëm kostot aktuale, për të cilat do të japë edhe ndarjen e detajuar.

Neni 22

Ndarja e detajuar e kostove të lidhjes

1. Ndarja e detajuar e kostove do të përfshijë:

a) kostot e përgatitjes së projektit dhe të mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar;

b) kostot e blerjes së pajisjeve, mjeteve dhe materialeve të nevojshme për lidhjen;

c) kostot e punimeve;

d) kostot e punimeve specifike dhe operacionale që kërkohen për të lidhur një objekt me rrjetin;

e) pjesa e kostove të sistemit që shkaktohen si parakusht për lidhjen e një objekti në rrjetin e shpërndarjes ose të transmetimit (kostot e lidhjes në gjysmëthellësi të rrjetit); dhe

f) çdo kosto tjetër që konsiderohet e nevojshme për përfundimin e lidhjes, ashtu si është aprovuar nga ERE.



Neni 23

Rregulla të përgjithshme në lidhje me tarifat e lidhjes

1. Kur përcakton tarifat e lidhjes, operatori i rrjetit do të marrë parasysh parimet e kostove të lidhjes në gjysmëthellësi të rrjetit.

2. Operatori i rrjetit mund të përcaktojë raportin e përdorimit të kapacitetit të rrjetit për secilin seksion të veçantë të rrjetit, në të cilin është bërë lidhja individuale ose mund të zgjedhë të përdorë një vlerë të vetme të raportit të përdorimit të kapacitetit të rrjetit për të gjitha pjesët e rrjetit të operatorit të rrjetit me presione pune poshtë dhe mbi 6 bar (përkatësisht për lidhje standarde dhe të personalizuar ose lidhje në grup).

3. Operatori i rrjetit do të aplikojë tek ERE për miratimin e ndarjes së detajuar të kostove dhe të tarifave, përfshirë edhe kostot e lidhjes në gjysmëthellësi të rrjetit (për çdo kategori lidhjeje), jo më vonë se 18 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

4. Për çdo vit pasardhës, pas miratimit të parë, sipas paragrafit 3 më sipër, operatori i rrjetit do të paraqesë në ERE për miratim, jo më vonë se data 30 nëntor, ndarjen e detajuar të kostove dhe të tarifave, përfshirë edhe kostot për lidhjen në gjysmëthellësi të rrjetit (për çdo kategori lidhjeje), përpara zbatimit të tyre gjatë vitit në vijim.

5. Pas aprovimit të tarifave të lidhjes, operatori i rrjetit do të bëjë shpalljen e tyre nëpërmjet publikimit në faqen e tij të internetit.

6. Operatori i rrjetit mund të bëjë zbritje dhe të ofrojë kushte të veçanta pagese për tarifat e lidhjes, por të tilla përfitime do t'u ofrohen të gjithë përdoruesve të mundshëm në të njëjtat kushte.

7. Projekti i lidhjes i përgatitur nga operatori i rrjetit dhe i pranuar nga aplikanti dhe çmimi përkatës që do të paguhet për lidhjen, kur është rënë dakord, do të jenë përfundimtar, përveç rasteve që është rënë dakord ndryshe në marrëveshjen e lidhjes midis palëve. Çdo ndryshim i projektit të lidhjes, si rezultat i modifikimeve të mëvonshme të bëra në mënyrë të njëanshme nga operatori i rrjetit gjatë zbatimit të tij, nuk do të rezultojë në kosto shtesë për aplikantin.

Neni 24

Përcaktimi i tarifave standarde të lidhjes

1. Në varësi të kapacitetit maksimal të lidhjes ose të llojit të matësit, përcaktohen llojet e mëposhtme të lidhjeve:

Lloji i matësit	Kapaciteti maksimal
G-4	40 kw
G-6	60 kw
G-10	100 kw

2. Tarifat standarde të lidhjes përfshijnë të gjitha kostot që kanë të bëjnë me ndërtimin e lidhjes nga pika e lidhjes deri në pikën e matjes dhe përcaktohen për secilin lloj të një lidhjeje standarde, sipas paragrafit 1 më lart, mbi bazën e:

a) koston mesatare vjetore të përgatitjes së projektit dhe të mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar për lidhjen standarde të një lloji të veçantë. Për qëllim të vlerësimit të tarifave për vitin e parë, operatori i rrjetit mund të përdorë vlerësime kostoje të arsyeshme dhe të detajuara;

b) sasive mesatare vjetore të standardizuara të pajisjeve, mjeteve dhe materialeve të nevojshme për instalimin e lidhjeve standarde të një lloji të veçantë;

c) koston mesatare vjetore të punimeve për ndërtimin e lidhjes standarde të një lloji të veçantë; dhe

d) koston mesatare vjetore të punimeve specifike dhe operacionale që kërkohen për të lidhur objektet me rrjetin.

3. Tarifat e lidhjes standarde do të ndahen në dy grupe:

a) tarifë fikse e lidhjes standarde, për çdo lloj lidhjeje standarde në një distancë, nga rrjeti deri në 20 metra; dhe

b) tarifë e ndryshueshme e lidhjes standarde, e cila do të varet nga gjatësia shtesë për çdo distancë nga rrjeti që tejkalon 20 metra. Tarifa e ndryshueshme e lidhjes standarde duhet të shprehet për çdo metër distancë për secilin lloj të lidhjeje standarde.

4. Operatori i rrjetit ka të drejtë të ngarkojë tarifën fikse të lidhjes standarde për secilin lloj të lidhjeve standarde, përfshirë rastet kur distanca nga rrjeti është më e shkurtër se 20 metra.

5. Ndarjet e detajuara të koston së lidhjes dhe tarifat e lidhjes - të dyja për secilin lloj të lidhjeve standarde - do të miratohen nga ERE para aplikimit të tyre.



Neni 25

Përcaktimi i tarifave për lidhjet e personalizuara

Tarifat për lidhje të personalizuara janë të barabarta me shumën e kostove aktuale, të:

- a) përgatitjes së projektit;
- b) mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm, lejet e dhëna nga të gjitha autoritetet përkatëse dhe/ose miratimet e tyre;
- c) shpenzimeve të pronës për një lidhje të veçantë, nëse kjo do të ishte e nevojshme;
- d) kryerjes së punimeve përgatitore të nevojshme për realizimin e lidhjes;
- e) blerjes së pajisjeve, mjeteve dhe materialeve të nevojshme për realizimin e lidhjes;
- f) punëtorëve të angazhuar në ndërtim, makinerive dhe punimeve elektrike që lidhen me ndërtimin e një lidhjeje, përdorimin e makinerive të drejtuara nga operatori, mjetet speciale dhe pajisjet, dhe përdorimin e automjeteve me shofer;
- g) pajisjes së pikës së matjes;
- h) projektimit gjeoteknik dhe gjeodezik të rrugës, studimeve të rrugës së lidhjes dhe përditësimit të librave kadastralë të tubacionit dhe modifikimet në hartat përkatëse kadastrale;
- i) komisionimit dhe vënies në punë;
- j) kryerjes së punimeve të tjera të specializuara dhe operacionale që kërkohen për të lidhur një objekt në rrjet: vizitat në vend për të identifikuar vendndodhjen e objekteve, rrjeteve dhe rrugëve të lidhjes; mbikëqyrjes profesionale të ndërtimit, montimit të makinerive dhe punimeve në tubacionet e gazit; dhe kontrollit teknik të instalimeve të brendshme të gazit, para furnizimit fillestar me gaz të lidhjes, në përputhje me rregulloren teknike dhe Kodin e Rrjetit, me të cilin do të lidhet objekti dhe kriteret e specifikuar në këtë Rregullore.

Neni 26

Përcaktimi i tarifave për lidhjet në grup

1. Kostot e lidhjes në grup përcaktohen sipas së njëjtës metodologji, si për lidhjet e personalizuara.
2. Tarifat e lidhjes bazohen në koston e lidhjes në grup të ponderuara me numrin e pajisjeve matëse individuale dhe kapacitetit të instaluar brenda objektit.

3. Kostoja e përgjithshme e lidhjes në grup mund të mbartet fillimisht nga pronari i objektit dhe t'i kthehet atij më vonë nga pronarët/përdoruesit e apartamenteve/zyrave individuale, bazuar në parimet e tarifimit, sipas paragrafit 2 më lart.

Neni 27

Përcaktimi i tarifave të lidhjes për rastet e veçantë

1. Tarifat për lidhje të rasteve të veçanta përcaktohen sipas metodologjisë së mëposhtme:

- a) kostot e lidhjes në gjysmëthellësi të rrjetit, që kanë të bëjnë me një lidhje të një rasti të veçantë, përcaktohen vetëm për rritjen e kapacitetit të aprovuar;
- b) në masën kur ekziston nevoja për të zëvendësuar pajisjen matëse (për shembull, në rastet kur matësi ekzistues ka tejkaluar 50% të jetës së tij), do të jetë kostoja e pajisjes së re matëse;
- c) në rast të modifikimeve të një lidhjeje, tarifat e lidhjes përcaktohen bazuar në kostot aktuale shtesë të bëra për realizimin e një lidhjeje të tillë;
- d) kur lidhja e një objekti bëhet pas një shkëputjeje të detyrues, tarifat e lidhjes përcaktohen bazuar në kostot aktuale shtesë të bëra për realizimin e një lidhjeje të tillë;
- e) në rast të një lidhjeje të re, për shkak të zhvendosjes ose të prishjes së një objekti që ka qenë i lidhur më parë dhe që nuk është iniciuar nga operatori i rrjetit, aplikohet i njëjti rrjet i tarifimit si për lidhjen origjinale. Megjithatë, në raste të tilla, në atë masë që disa elemente të lidhjes ekzistuese (të zhvendosura ose prishura) mund të ripërdoren pa cenuar sigurinë për qëllimin e lidhjes së re, këto kosto do të zbriten.

PJESA V

PRONËSIA E LIDHJES

Neni 28

Kufijtë e pronësisë

Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe në marrëveshjen e lidhjes midis operatorit të rrjetit dhe aplikantit, asetet e lidhjes pasi të jenë përfunduar, testuar dhe komisionuar dhe të jenë bërë operacionale nga pika e lidhjes e deri në pikën e matjes, përfshirë pajisjen matëse, do të jenë pronë e operatorit të rrjetit.



PJESA VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind si rezultat i moszbatimit të kësaj Rregulloreje do të trajtohet nga ERE në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë.

VENDIM
Nr. 177, datë 14.11.2019

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“SMART WATT” SHPK PËR DHËNIEN
E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-s,
PËR SHITJEN E KUOTAVE TË
SHOQËRISË “SMART WATT” SHPK TE
SHOQËRIA “ETS” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 6.2, të “Licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 102/1-1 prot., datë 13.11.2019, për kërkesën e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për shitjen e kuotave të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. te shoqëria “ETS” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 542 prot., datë 10.9.2019, ka përcjellë në ERE njoftimin për ndryshimin e pronarit të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., si dhe ka kërkuar nga ERE-ja

miratimin e transferimit të aksioneve të ortakut kryesor të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., te shoqëria “ETS” sh.p.k.

- Me qëllim saktësimin e kësaj kërkeje, ERE-ja me shkresën nr. 542/1 prot., datë 26.9.2019, iu drejtua shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. duke i bërë me dije se ERE lëshon autorizime për kryerjen e shitjes së kuotave në rastin e ndryshimit të ortakut kryesor të saj.

- Në përgjigje të shkresës së ERE-s, shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 542/2 prot., datë 16.10.2019, përcolli saktësimin e kërkesës së saj duke kërkuar dhënien e autorizimit nga ERE-ja për kryerjen e shitjes së aksioneve nga shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., te shoqëria “ETS” sh.p.k.

- Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe mbështetur në ligjin nr. 9901, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak të formës së organizimit të saj, pavarësisht pasaktësisë së kërkesës së aplikuesit, në kuptim të kësaj vendimmarrjeje i referohemi Ortakut dhe Kuotave.

- Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., ka përcjellë edhe dy shkresa të MIE-s me nr. 4146/4 prot., datë 27.8.2019, me anë të të cilave Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) i ka miratuar transferimin e së drejtës së ndërtimit të dhënë me Miratimin Përfundimtar nr. 5864/11 prot., datë 14.11.2018, si dhe transferimin e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi nga shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., te shoqëria “ETS” sh.p.k.,

- Me shkresën nr. 4146/6 prot., datë 14.10.2019, MIE shprehet për revokimin e transferimit të së drejtës së ndërtimit nga shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., te shoqëria ETS sh.p.k., për shkak se vetë shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., i ka kërkuar MIE-s të korrigjojë/revokojë shkresën me nr. 4146/4 prot., datë 27.8.2019, në mënyrë që të mundësohet miratimi i kalimit të plotë të aksioneve të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., te shoqëria “ETS” sh.p.k.

- MIE, në bazë të kërkesës së shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. nr. 4146/5 prot., datë 30.9.2019, ka revokuar transferimin e të drejtës së ndërtimit. Në këtë korrespondencë MIE shprehet se: “...sa i përket transferimit të kuotave (aksioneve)



nga një shoqëri te tjetra, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, ky transferim nuk ka nevojë për miratim nga MIE...”.

- Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k. është mbajtëse e licencës me nr. 440, seria P19, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 72, datë 10.5.2019. Objekt i veprimtarisë së “SMART WATT” sh.p.k. është kryerja e aktivitetit të importit, eksportit, tregtimit dhe furnizimit me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërtimin e impianteve të energjisë së rinovueshme, prodhim të energjisë, studim dhe konsulencë në aktivitetin e energjisë elektrike. Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

- Kjo kërkesë vjen në zbatim të pikës 6.2, të Licencës së Prodhimit të Energjisë Elektrike.

- Sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve, që shoqëria “SMART WATT” sh.p.k. ka depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 542/3, datë 28.10.2019, rezulton se ka miratuar shitjen e kuotave në pjesëmarrje në masën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., që zotëron ortakun i vetëm i shoqërisë, te blerësi, shoqëria “ETS” sh.p.k.

- Në lidhje me transferimin e kuotave të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., MIE, duke mbajtur në konsideratë parashikimin e nenit 16, “Kufizimet”, të kontratës nr. 6380, datë 31.12.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiq “SMART WATT” sh.p.k. me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Topojë, qarku Fier”, shprehet se: “...sa i përket transferimit të kuotave (aksioneve) nga një shoqëri te tjetra, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, ky transferim nuk ka nevojë për miratim nga MIE...”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për shitjen e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. që zotëron ortakun z. Endrit Beqaj, te blerësi, shoqëria “ETS” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet

ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 178, datë 14.11.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “KROI
MBRET ENERGJI” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et:
“BACKA 1”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1600 kw; HEC-i “BACKA 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000
kw, HEC-i “BACKA A”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 500 kw, HEC-i “BACKA
B”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 500
kw, HEC-i “BACKA C”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 720 kw, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 7320 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10, pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 102/4 prot., datë 11.11.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 634 prot.,



datë 11.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, me cilësinë e “Autoritetit kontraktues”, e përcaktuar si e tillë në bazë të VKM-së nr. 616, datë 7.9.2011, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe dhënien me koncesion të hidrocentraleve ‘Stravecka 1’ dhe ‘Stravecka 2’ dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhje konkurrese që i jepet shoqërisë”, ka lidhur me shoqërinë “Alba Konstruktion” sh.p.k., me cilësinë e koncesionarit, kontratën e koncesionit të formës “BOT” nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, “Për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e HEC –eve, ‘Backa 1’, ‘Backa 2’, ‘Backa A’, ‘Backa B’, ‘Backa C’ dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës, nga koncesionari tek autoriteti kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate”.

- Kapaciteti total për të cilin kërkon të licencohet shoqëria është i njëjtë në kontratën e koncesionit dhe në projektin e zbatimit, por në projektin e zbatimit është referuar për HEC-et emërtesa sipas vendndodhjes ku do të ndërtohet secili dhe janë shtuar veprat e marrjes për HEC-et “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 92/15 prot., datë 16.2.2015, drejtuar shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., dhe për dijeni AKBN-së, ka përcjellë te këto të fundit: “Miratimin e ndryshimit të projektit të zbatimit të miratuar me shkresën nr. 92/3 prot., datë 4.4.2013 të HEC-ve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B”, “Backa C”.

- Kontrata e koncesionit ka një kohëzgjatje prej 35 vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Koncesionari merr përsipër të vendosë në punë hidrocentralin brenda 15 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit, siç parashikuar në grafikun e punimeve, të paraqitur në aneksin 2 të kontratës.

- Nga aplikimi rezulton se të gjitha veprat hidroenergetike janë ndërtuar që në vitin 2016 dhe pritet të vihen në punë në nëntor të vitit 2019.

- Aplikimi i shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim-neni 9, pika 1, germa “a”, germa “b”, germa “c”, janë plotësuar;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor-neni 9, pika 2: gjerat “a”/“b”, germa “c”, germa “d”, germa “e”, germa “f” dhe germa “g” janë plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal-neni 9, pika 3, germa “a”, germa “b”, germa “c”, germa “d”, janë plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për HEC-et:

- neni 9, pika 4.1.1, të dhënat teknike për HEC-et, janë plotësuar;

- neni 9, pika 4.1.2, të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, janë plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 4.1.3, dokumentacioni teknik dhe grafik: germa “a”, germa “b”, germa “c”, germa “d”, janë plotësuar pjesërisht;

- neni 9, pika 4.1.4, dokumentacioni tekniko-ekonomik: germa “a”, germa “b”, germa “c”, germa “d”, germa “e”, janë plotësuar pjesërisht.

- Leje nga institucione të tjera-neni 9, pika 4.1.5: germa “a”, germa “b”, germa “c”, janë plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2.

- Germa “f” (Marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës):

- shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., ka paraqitur kontratën e koncesionit nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, të lidhur midis palëve: Koncesionarit “Alba Konstruktion” sh.p.k. dhe METE-s, me cilësinë e autoritetit kontraktues, “Për ndërtim-operimin dhe transferimin e hidrocentraleve: “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B”, “Backa C”, me përfundimin e periudhës së përcaktuar në kontratën e koncesionit tek autoriteti kontraktues.

- MIE, me shkresën, nr. 92/15 prot., datë 16.2.2015, ka dhënë “Miratimin e ndryshimit të projektit të zbatimit të miratuar me shkresën nr. 92/3 prot., datë 4.4.2013 të HEC-ve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B”, “Backa C”.

- Germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte



dhurimi, kontrata premtimi shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti):

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, nr. 3487 prot., datë 20.11.2018, të lidhur midis palëve: Bashkia Skrapar, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat 1 (një) vjeçar, e cili fillon nga dita e nesërme e nënshkrimit të saj.

- Objekti i kësaj kontrate është :“Dhënia me qira e fondit pyjor/kullësor me gjatësi lineare 6.972 km, nga të cilat 0.87 km shkurre, 6.1 km kullotë, e përfshirë në ekonominë pyjore Turbohovë-Potom, Ek Backë, në administrim/pronësi të Bashkisë Skrapar, shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë për ndërtimin e hidrocentraleve: “Backa 1” , “Backa 2” , “Backa A” , “Backa B” dhe “Backa C” në pellgun ujëmbledhës, përroi Backës, Straveckë.

- Kontrata e lidhur nga palët, për një periudhë njëvjeçare, për shkak të përfundimit të afatit të ushtrimit të veprimtarisë, humbet fuqinë juridike në datën 20.11.2019.

- Në kontratë mungojnë numrat kadastral të parcelave ku shtrihet projekti.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal-neni 9, pika 3:

- Germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit). Shoqëria ka paraqitur pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2018, nga të cilat rezulton se ka ushtruar aktivitetin për ndërtimin e hidrocentralit Potom Skrapar dhe nuk rezulton të ketë gjeneruar fitim.

- Germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Shoqëria ka paraqitur vërtetimin nr. 213, prot., datë 2.9.2019, të lëshuar nga Credins Bank, i cili vërteton se shoqëria ka llogari aktive në lekë, me gjendje kreditore 300.000.000 ALL (treqind milionë lek). Për pjesën tjetër të investimit, për të cilën është parashtruar më poshtë në Planin e Biznesit, vlera e investimit që shoqëria mbulon nëpërmjet kredisë rezulton të jetë 80%.

- Neni 9, pika 4.1.3. Dokumentacioni teknik dhe grafik-germa “c”. Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në harte me

shkallë 1:25000. Nga ky dokumentacion rezulton se janë përcaktuar koordinatat e shtrirjes së projektit, por nuk janë përcaktuar numrat e parcelave dhe numrat e regjistrit të kadastrës.

- Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni tekniko-ekonomik-germa c. Oponenca teknike e projektit. Shoqëria ka depozituar në ERE vetëm Raportin e Oponencës Teknike mbi projektin e zbatimit të HEC-ve: “Backa 1” , “Backa 2” , “Backa A” , “Backa B” dhe “Backa C” , miratuar nga MIE me shkresën nr. 92/15 prot., datë 16.2.2015.

- Leje nga institucione të tjera- neni 9, pika 4.1.5, germa b. Leja e përdorimit të ujit.

Shoqëria ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Agjencia e Ujit, të Basenit Seman, nr. 442 prot., datë 9.11.2011, ku citohet: “Vërtetojmë se Subjekti ‘Alba Konstruktion’ sh.p.k, ka depozituar pranë AUB Seman, kërkesën për shfrytëzimin e përroit të Staroveckës, për leje për miratim në parim në datë 9.11.2011. Shoqëria “Alba Konstruktion” sh.p.k, parashikon të shfrytëzojë këtë përrua për HEC-et: HEC “A”, HEC “C”, HEC “B”, HEC “1”, HEC “2”, sipas të dhënave teknike përkatëse.

- Kontrata e koncesionit, e formës “BOT”, nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, ka një afat 35-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE-ja, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

- Sipas llogaritjes së afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit të formës “BOT”, me nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, rezulton se shoqëria ka humbur 7 vjet e 4 muaj nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 22 vjet e 8 muaj.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.



- Në pikën 4, të nenit 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: “Backa 1”, me kapacitet të instaluar 1600 kw; “Backa 2”, me kapacitet të instaluar 4000 kw,

“Backa A”, me kapacitet të instaluar 500 kw; “Backa B”, me kapacitet të instaluar 500 kw dhe “Backa C”, me kapacitet të instaluar 720 kV, me kapacitet total 7320 kw, për periudhën e mbetur nga afati i parashikuar në kontratën e koncesionit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë